



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministrit të Drejtësisë - Ured Ministra Pravde - Office of the Minister of Justice

Nr. 456/2025
Datë: 31.12.2025

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2), dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare nr. 7, 01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 22 (paragrafi 5) të Ligjit nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, në përputhje me nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, si dhe në bazë të Vendimit DPSDPL. Nr. 03/2025, të datës 11.12.2025, të Komisionit Disiplinor për Ndërmjetësues të Ministrisë së Drejtësisë, Ushtrues i Detyrës së Ministrit të Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndërmjetësuesit z. Muharrem Shefkiu, i revokohet Licenca e Ndërmjetësuesit nr.42/2011.
2. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Me Vendimin e Komisionit Disiplinor për Ndërmjetësues të Ministrisë së Drejtësisë DPSDPL. Nr. 03/2025, të datës 11.12.2025, ndaj ndërmjetësuesit z. Muharrem Shefkiu është shqiptuar masa disiplinore "Propozim për revokimin e licencës nga Ministri i Drejtësisë", për shkak të shkeljeve të rënda ligjore dhe profesionale të konstatuara gjatë ushtrimit të veprimtarisë së ndërmjetësimit.

Nga arsyetimi i Vendimit të Komisionit Disiplinor për Ndërmjetësues rezulton se veprimet e ndërmjetësuesit gjatë ushtrimit të detyrës, përfshirë hartimin e marrëveshjes së ndërmjetësimit në rastin konkret, kanë qenë në kundërshtim me Ligjin përkatës për Ndërmjetësim, Udhëzimin Administrativ MD-Nr.04/2019 për Mbikëqyrjen, Përgjegjësinë dhe Procedurën Disiplinore të Ndërmjetësuesve, Kodin e Mirësjelljes së Ndërmjetësuesve dhe parimet themelore të Ndërmjetësuesve, duke përbërë shkelje të rënda që cenojnë profesionalizmin, paanshmërinë dhe besueshmërinë e procesit të ndërmjetësimit.

Kundër këtij vendimi, ndërmjetësuesi ka paraqitur ankesë pranë Ministrit të Drejtësisë, e cila, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe arsytimit të Komisionit Disiplinor, është refuzuar si e pabazuar me Vendimin Nr. 439/2025, të datës 24.12.2025, duke u lënë në fuqi Vendimin e Komisionit Disiplinor.

Ministri i Drejtësisë, pas vlerësimit të gjithanshëm të Vendimit të Komisionit Disiplinor, vlerëson se veprimet e konstatuara përbëjnë shkelje disiplinore të rënda në kuptim të Ligjit nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim dhe se, duke marrë parasysh natyrën dhe peshën e tyre, si dhe ndikimin në ushtrimin e rregullt dhe të besueshëm të veprimtarisë së ndërmjetësimit, revokimi i licencës paraqet masë të drejtë, të domosdoshme dhe proporcionale.

Për këto arsye, në përputhje me nenin 22 paragrafi 5 të Ligjit nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



Blerim SALLAHU

Ushtrues i detyrës së Ministrit të Drejtësisë

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet konflikt administrativ në gjykatën kompetente në afat prej tridhjetë (30) ditësh.

Vendimi iu dërgohet:

- Z. Muharrem Shefkiu;
- Kabinetit të Ushtruesit të Detyrës së Ministrit të Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretares së Përgjithshme;
- Departamentit për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika.
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.